



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



Në pajtim me dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 73 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d dhe nenit 48 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, dhe të nenit 4 të Udhëzimit administrativ nr. 01/2016, për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencave të komiteteve konsultative në Komuna, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 06.08.2018, miratoi këtë

## **V E N D I M**

### **PËR THEMELIMIN E KOMITETIT KONSULTATIV**

#### **Neni 1**

Miratohet Vendimi për themelimin e Komitetit konsultativ të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

#### **Neni 2**

Komiteti i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, përbëhet nga pesë (5) deri në shtatë (7) anëtarë, qytetarë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare, të cilët janë njohës të fushës përkatëse.

#### **Neni 3**

Caktimi i anëtarëve në Komitetin e cekur në nenin 2 të këtij vendimi, bëhet përmes shpalljes së konkursit publik, me mandat 4-vjeçar, me mundësi të përzgjedhjes edhe për një mandat.

#### **Neni 4**

Caktimin e kriterëve, shpalljen e konkursit, përzgjedhjen e anëtarëve të Komitetit të cekur në nenin 2 të këtij vendimi, do ta bëjë paneli përzgjedhës i caktuar nga Kuvendi i Komunës, në përbërje:

1. Mirsad Vitia, përfaqësues i Kuvendit,
2. Vesel Makolli, përfaqësues i Kuvendit,
3. Suzan Kika, përfaqësuese e Kuvendit,
4. Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit dhe
5. Albulena Nrecaj, përfaqësuese nga shoqëria civile.

## Neni 5

Kompetencat e Komitetit konsultativ janë: dhënia e propozimeve të rregulloreve të ndryshme, hulumtime të ndryshme, mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari i Komunës, komitetet e përhershme apo Kuvendi i Komunës në fushën përkatëse, paraqitja e pikëpamjeve dhe mendimeve të qytetarëve te Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës, propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara, propozime këto të cilat nuk janë obliguese për Kuvendin e Komunës, por duhet të merren parasysh në zhvillimin e politikave komunale.

## Neni 6

Çështje tjera lidhur me Komitetin konsultativ do të rregullohen me Udhëzimin administrativ nr. 01/2016, procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencave të komiteteve konsultative në Komuna.

## Neni 7

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.

## Neni 8

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-020/04-194109/18, më 08.08.2018

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Agim Kuleta**

